

VENDIM
Nr. 142, datë 20.3.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL DHE OBJEKTI, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 42, ME EMËRTIM “INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË MBROJTJES”, ME VENDNDODHJE BULEVARDI “ZHAN D’ARKË”, TIRANË, DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 572, DATË 3.9.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME, TË OBJEKTIT NR. 42, ME EMËRTIM “INSTITUTI I STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE TË MBROJTJES”, PËR SHKOLLËN SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, DHE SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 786, DATË 14.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”, DHE NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe objekti, me sipërfaqe të përgjithshme 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhan D’Arkë”, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për ndërtim rruge publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet sipërfaqja 766 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes”, me vendndodhje bulevardi “Zhan D’Arkë”, Tiranë, sipas planvendosjes, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në pronësi ose përdorim Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe portën hyrëse, me kangjella metalike dhe me bazament betonarme, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike, që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, dhe për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

5. Në vendimin nr. 572, datë 3.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në titullin e vendimit, fjalët “... Ministrisë së Punëve të Brendshme ...” shfuqizohen;


b) Pika 1, e vendimit, riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 40-vjeçare, të objektit nr. 42, me emërtim “Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes”, nga Ministria e Mbrojtjes te Shkolla Shqiptare e Administratës Publike”, të truallit funksional dhe objektit me sipërfaqe të përgjithshme 1077.28 (një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e tetë) m², sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevojat e administratës së këtij institucioni.”

c) Në pikën 2, të vendimit, fjalët “... Ministrisë së Punëve të Brendshme ...”, zëvendësohen me “... Shkollës Shqiptare të Administratës Publike ...”.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, drejtori i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

PLAN VENDOSJA
e Pronës nr. 42 "Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes", Tiranë
Objekti dhe Sip. e truallit që kërkohet për kalim në pronësi të Bashkisë Tiranë.



Hartuar 03.10.2018

Shkalla 1:1000

PUNOI
Topograf Ramiz HAXHIU

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. Ferdi HYRAJ

